

Bazuar në nenin 36 paragrafi 17 dhe nenin 65 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjin nr. 03 / L - 209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) si dhe nenin 3.3 të Rregullores nr. 2001/25 Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës me datë 19 Mars 2014, lëshon këtë:

### **Udhëzim Nr. 01/2014**

#### **Mbi kalkulimin dhe regjistrimin e “Kostove të Shtyra të Blerjes” (ang. Deferred acquisition cost – DAC) në Pasqyrat Financiare**

1. Ky udhëzim rregullon dhe standardizon procedurën si dhe metodologjinë për kalkulimin dhe raportimin e “Kostove të Shtyra të Blerjes” në pasqyrat financiare.
2. Të gjithë Siguruesit, Risiguruesit dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) do të jenë të obliguara të zbatojnë këtë udhëzim për kalkulimin dhe regjistrimin e “Kostove të Shtyra të Blerjes” (në tekstin e mëtejmë: DAC) në pasqyrat e tyre financiare, duke filluar nga periudha raportuese janar-mars 2014.
3. Te gjithë Siguruesit, Risiguruesit dhe BKS-ja obligohen që fillimisht të kalkulojnë (nxjerrin) raportin e primeve të pafituara (RPP), individualisht për secilën klasë të biznesit.

$$\% \text{ } RPP = \frac{RPP}{BPSH}$$

ku:

% RPP = Raporti i primeve të pafituara

BPSH = Bruto Primet e Shkruara

RPP = Rezerva për primet e pafituara

4. Shpenzimet si, a) *rrogat e operatoreve*, b) *komisionet e agjenteve/brokerave*, c) *Tatimi 5%* dhe d) *provizioni ndaj BQK 1.5%*, të ndara sipas secilës klasë biznesi do të pranohen për kalkulimin dhe regjistrimin e DAC-it në Pasqyrat Financiare të Siguruesit, Risiguruesit dhe BKS-së. Kur raporti i primeve të pafituara (%RPP) i kalkuluar për secilën klasë të biznesit, shumëzohet me gjithsej llojin e shpenzimeve të lartcekura të kalkuluar për secilën klase të biznesit, fitohet rezultati i DAC, siç është paraqitur në shtojcën e këtij dokumenti.

$$DAC = SHP \times \%RPP$$

5. Siguruesit, Risiguruesit dhe BKS-ja janë të obliguar që rezultatin e fituar nga metodologja e sipërme të raportojnë në pasqyrat financiare sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar.
6. Është në përgjegjësinë e Siguruesit, Risiguruesit, dhe BKS-së, të paraqesin informacione të saktë për kalkulimin e DAC-it.
7. Çdo prezantim jo i saktë i informacioneve lidhur me DAC-in do të jetë subjekt i mbikëqyrjes në vend dhe i ndëshkimeve të parapara me legjislacionin në fuqi.
8. Ky udhëzim hyn në fuqi me datë 01 prill 2014



Bedri Hamza

Kryesues i Bordit Ekzekutiv

## SHTOJCË

**Shembull për kalkulimin e DAC-it:**

$$\% \ RPP = \frac{RPP}{BPSH} \quad \% \ RPP = \frac{450}{1000} = 45 \%$$

<u>Përshkrimi</u>	<u>Shuma</u>
Rrogat e operatorëve	250
Komisionet e agjentëve/brokerëve	210
Tatimi 5%	180
Provizoni ndaj BQK 1.5%.	50
 <u>Gjithsej Shpenzimet</u>	 <u>690</u>

$$\text{DAC} = \text{SHP} \times \% \text{RPP}; \quad \text{DAC} = 690 \times 45\% = 311$$